L I G J
Nr.8754, datë 26.3.2001

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN PËR HARMONIZIMIN E RREGULLAVE PËR KONTROLLIN KUFITAR TË MALLRAVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2955, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONVENTA
NDËRKOMBËTAREPËR HARMONIZIMIN E RREGULLAVE PËR KONTROLLIN KUFITAR TË MALLRAVE

HYRJA

Palët kontraktuese,
Duke patur si dëshirë të përmirësojnë lëvizjen ndërkombëtare të mallrave,
Duke patur në mend nevojën për të lehtësuar kalimin e mallrave në kufi,
Duke venë re se masat e kontrollit që zbatohen në kufi kryhen nga shërbime të ndryshme të kontrollit,
Duke njohur faktin që kushtet në të cilat kryhen këto kontrolle mund të harmonizohen pa dëmtuar qëllimin në vetvete të kontrollit dhe të efektivitetit të tij,
Të bindur se harmonizimi i rregullave të kontrollit kufitar përbën një mjet të fuqishëm për arritjen e këtyre objektivave,
kanë rënë dakord si vijon:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Konvente:
(a) "Dogana" do të thotë Shërbimi Qeveritar që është përgjegjës për administrimin dhe zbatimin e ligjit të doganave, lidhur me mbledhjen e taksave nga doganat, si dhe ka përgjegjësi për zbatimin e ligjeve dhe rregullave lidhur me të, ku ndër të tjera përfshihet transportimi, tranzitimi dhe

eksportimi i mallrave;

(b) "Kontroll Doganor" do të thotë masat e zbatuara për të siguruar përputhjen me ligjet dhe rregullat të cilat autoritetet doganore duhet të zbatojnë gjatë aktivitetit të tyre;

(c) "Inspektim Mjeko – Sanitar" do të thotë kontrollet e ushtruara për mbrojtjen e jetës, të shëndetit, të personit, duke përjashtuar kontrollin veterinar;

(d) "Kontroll Veterinar" do të thotë kontrolli shëndetësor i ushtruar te kafshët dhe prodhimet e tyre, duke synuar në mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave dhe kafshëve. Ky kontroll do të ushtrohet edhe mbi mjetet dhe të mirat të cilat do të shërbejnë për transportimin e sëmundjeve të kafshëve;

(e) "Kontroll Fitosanitar" do të thotë kontrolli që ka si qëllim parandalimin e shpërndarjes dhe hyrjen në kufijtë shtetërore të sëmundjeve të bimëve ose të prodhimeve nga bimët;

(f) "Kontrolli për Standardet Teknike" do të thotë kontrolli i ushtruar për të siguruar që mallrat të gëzojnë standardet minimum kombëtar dhe ndërkombëtar, ashtu siç përcaktohet në ligjet dhe rregulloret e veçanta;

(g) "Kontroll i Cilësisë" do të thotë, përveç formave të kontrolleve të përmendura më sipër, kontroll i ushtruar më qëllim që mallrat të jenë brenda parametrave kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ashtu siç përcaktohet në ligjet e rregulloret e veçanta;

(h) "Kontrolli i Shërbimeve" do të thotë çdo shërbim i kryer për të kontrolluar gjithë kontrollet e kryera më parë, lidhur me importimin, eksportimin ose tranzitimin e mallrave.

Neni 2
Qëllimi

Me qëllim lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave, kjo Konventë ka si qëllim të përmirësojë kuadrin ligjor për kryerjen e formaliteteve sidomos të numrit dhe kohëzgjatjes së kontrollit, në veçanti të koordinimit të rregullave dhe procedurave kombëtare dhe ndërkombëtare për kryerjen e kontrollit.

Neni 3
Shtrirja

1. Kjo Konventë aplikohet mbi të gjithë mallrat e importuara, të eksportuara ose në tranzit, të cilat janë transportuar me një nga mjetet e transportit, qoftë ky detar, rrugor dhe ajror.

2. Kjo Konventë do të aplikohet për të gjithë shërbimet e kontrollit të kryera nga palët kontraktuese.

KREU II
HARMONIZIMI I PROCEDURAVE

Neni 4
Koordinimi i Kontrolleve

Palët nënshkruese, brenda mundësive të tyre, do të ndërmarrin masa për harmonizimin e rregullave në kontrollin e shërbimeve doganore dhe të shërbimeve të tjera të Kontrollit.

Neni 5
Mjetet e kërkuara për kryerjen e këtyre shërbimeve

Në mënyrë që kontrolli të kryhet në mënyrë të suksesshme, palët kontraktuese, brenda mundësive të tyre, dhe duke respektuar kuadrin e tyre të brendshëm ligjor, të sigurojnë:

(a) personelin e kualifikuar në përputhje me shkallën e kërkesave të trafikut;

(b) pajisjet dhe lehtësitë për kryerjen e kontrollit, duke patur parasysh llojin e transportit, mallrat të cilat do të kontrollohen, si dhe kërkesat e qarkullimit;

(c) udhëzime zyrtare në drejtim të personelit të kontrollit në mënyrë që aktiviteti i tyre të jetë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me rregullat e tjera të legjislacionit të brendshëm.

Neni 6
Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Palët kontraktuese marrin përsipër detyrimin të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, duke kërkuar të njëjtin bashkëpunim edhe nga autoritetet kompetente ndërkombëtare, me qëllim arritjen e qëllimeve të Konventës, duke u përpjekur kështu, në hartimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, në qoftë se kjo konsiderohet e nevojshme nisur nga rrethanat.

Neni 7
Bashkëpunimi ndërmjet vendeve të anëtarësuara në këtë Konventë

Në çdo rast, që një kufi i një shteti të caktuar kalohet, Palët kontraktuese të përfshira do të duhet të marrin masat e duhura, Që kur është e mundur, të lehtësojnë kalimin e mallrave.

Në këtë aspekt ato do të:

(a) përpiqen të marrin masa për një kontroll të shpejtë të mallrave dhe dokumenteve shoqëruese, duke krijuar lehtësi në qarkullimin e tyre;

(b) përpiqen që veprimet e tyre të jenë në pajtim:

me orët zyrtare të punës së postave kufitare;

me shërbimet e kontrollit që gjenden atje, të cilat janë të ngarkuara për kryerjen e kontrollit;

me kategoritë e mallrave, mënyrën e transportimit të tyre dhe në pajtim me procedurat e pranuara ose që janë në përdorim për tranzitimin ndërkombëtar të mallrave.

Neni 8
Shkëmbimi i Informacionit

Palët kontraktuese mund, me kërkesën e secilës, mund të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për zbatimin e detyrimeve të kësaj Konvente, ashtu siç është përcaktuar edhe te shtesat (anekset) e kësaj Konvente.

Neni 9
Dokumentacioni

1. Palët kontraktuese do të përpiqen të nxisin ndërmjet tyre dhe autoritetet ndërkombëtare kompetente për përdorimin e dokumentacionit, ashtu siç është parashikuar edhe në dokumentin e OKB-së.

2. Palët kontraktuese do të pranojnë dokumentet e miratuara sipas një procedure të caktuar, duke pasur parasysh që këto procedura të jenë në konformitet të plotë me ligjet e brendshme, duke respektuar ndër të tjera formën, autenticitetin dhe verifikimin, lexueshmërinë dhe kuptueshmërinë e tyre.

3. Palët kontraktuese do të marrin masa që dokumentacioni shoqërues dhe i domosdoshëm të përgatitet dhe vërtetohet në përputhje të plotë me legjislacionin e brendshëm të çdo vendi.

KREU III
RREGULLAT LIDHUR ME TRANZITIMIN E MALLRAVE

Neni 10
Mallrat në Tranzit

1. Palët kontraktuese, brenda mundësive të tyre, do të sigurojnë një trajtim të shpejtë dhe të thjeshtë të mallrave në tranzit, sidomos për mallrat të cilat transportohen nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e dispozitave të Tranzitimit Ndërkombëtar të Mallrave, duke parashikuar kufizimin e kontrolleve në rastet kur kjo diskutohet nga rrethanat e veçanta. Për këtë, do të merret në konsideratë edhe gjendja e vendeve të cilat nuk kanë dalje në det. Ato do të duhet të sigurojnë edhe zgjatjen e kohës së punës dhe dhënien e kompetencave më të mëdha për kontrollin kufitar të mallrave të cilat kryhen në bazë të dispozitave të Tranzitimit Ndërkombëtar të Mallrave.

2. Palët kontraktuese do të përpiqen të lehtësojnë në një masë sa më të madhe tranzitimin e mallrave me kamionë ose me mjete të tjera, duke u siguruar atyre shkallën e duhur të sigurisë.

KREU IV
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 11
Rendi Publik

1. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të pengojë zbatimin e kufizimeve ose ndalimeve, lidhur me importimin, eksportimin ose tranzitimin e mallrave të cilat janë vendosur nga rendi publik, rregulla të cilat kanë si qëllim mbrojtjen e jetës, shëndetit, sigurisë dhe moralit, mbrojtjen e mjedisit, pasurisë kulturore dhe industriale, pasurive dhe të drejtave intelektuale.

2. Megjithatë, kur është e mundur dhe pa ndonjë paragjykim për efektivitetin e këtyre kontrolleve, palët kontraktuese do të përpiqen të zbatojnë kontrollet, duke mbajtur parasysh edhe masat e përmendura në paragrafin e mësipërm, dhe ndër të tjera edhe masat të cilat janë përfshirë në nenet 6 dhe 9 të kësaj Konvente.

Neni 12
Masat Emergjente

1. Masat emergjente, të cilat një palë do të mund të aplikojë si pasojë e rasteve të veçanta, duhet të jenë në proporcion me arsyet dhe faktorët të cilët kanë çuar në ndodhjen e rasteve urgjente. Këto masa duhet të ekzistojnë sapo të hiqen ose mënjanohen faktorët që çuan në marrjen e këtyre masave urgjente.

2. Kur është e mundur, dhe pa asnjë paragjykim për efektivitetin e masave të ndërmarra, palët kontraktuese duhet të botojnë dispozitat të cilat janë zbatuar për marrjen e masave urgjente.

Neni 13
Shtesat (Anekset)

1. Anekset janë pjesë përbërëse e kësaj Konvente.

2. Anekse të reja, lidhur me sektorë të tjerë të kontrollit, mund të përfshihen në këtë Konventë duke respektuar procedurat e përcaktuara në nenet 22 dhe 24 të kësaj Konvente.

Neni 14
Marrëdhëniet me Traktate të tjera

1. Pa asnjë paragjykim të nenit 6, Konventa në fjalë nuk do të ketë superioritet mbi të drejtat dhe detyrimet që shtetet, anëtare të kësaj Konvente kanë në bazë të Traktateve të tjera ku ato janë palë, para se të jenë bërë palë në këtë Konventë.

Neni 15

1. Kjo Konventë nuk do të përjashtojë zbatimin e lehtësirave më të mëdha të cilat 2 ose më shumë shtete palë të kësaj Konvente, duan t'i japin njëri-tjetrit. Po ashtu, kjo Konventë nuk do të përjashtojë as edhe të drejtën e shteteve anëtare të bëhen anëtare të organizatave të ndryshme të integrimit ekonomik, siç është parashikuar në nenin 16, i cili bën fjalë për zbatimin e legjislacionit kombëtar në rastet e kontrolleve në pikat kufitare, me kushtin e vetëm që ky kontroll të mos pengojë lëvizjen e mallrave.

Neni 16
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi. Aprovimi dhe aderimi

1. Konventa, e cila është depozituar tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, do të jetë e hapur

për të gjitha shtetet dhe të gjitha organizatat e integrimit ekonomik rajonal në të cilat kanë aderuar shtete të veçanta, të cilat kanë të drejtën dhe kompetencën të negociojnë, të arrijnë marrëveshje dhe të zbatojnë marrëveshjen e cila lidhet me çështje të cilat mbulohen nga Konventa e mësipërme.

2. Organizatat e integrimit ekonomik rajonal, siç është folur edhe në paragrafin e mësipërm për çështjet e përfshira brenda kompetencës së tyre, ushtrojnë në emër të tyre, të gjitha të drejtat dhe detyrimet, të cilat sipas kësaj Konvente do t'i përkisnin shteteve të veçantë, të cilët janë palë pjesmarrëse të kësaj Konvente. Në raste të tilla, anëtarët e kësaj Organizate nuk kanë të drejtë të ushtrojnë individualisht të drejtat, përfshirë këtu edhe të drejtën e votës.

3. Shtetet, si dhe organizata e integrimit ekonomik rajonal, e përmendur më sipër, mund të bëhen palë kontraktuese në këtë Konventë:

(a) duke depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit ose aprovimit, pasi ajo është nënshkruar;

(b) ose duke depozituar instrumentin e aderimit.

4. Kjo Konventë do të qëndrojë e hapur që nga 1 Prill 1983 deri 31 Mars 1984, vetëm për nënshkrimin në Zyrat e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë nga të gjitha Shtetet dhe nga organizatat e integrimit ekonomik rajonal të përmendura në paragrafin 1.

5. Nga 1 prilli 1983 ajo do të jetë e hapur për aderimin e tyre.

6. Instrumenti i ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit do të depozitohet në Sekretariatin e Përgjithshëm në Kombet e Bashkuara.

Neni 17
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën pesë Shtetet kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

2. Pasi të pesë Shtetet të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për Palë të tjera Kontraktuese tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit, ose aderimit.

3.Çdo instrument i ratifikimit, pranimit, aprovimit, ose aderimit i depozituar pas hyrjes në fuqi të amendamenteve të kësaj Konvente, do të gjykohet të aplikojë në këtë Konventë të ndryshuar.

4. Çdo instrument i depozituar, pasi amendamentet të jenë pranuar në përputhje me procedurat e nenit 22, por para se instrumenti të ketë hyrë në fuqi, do të gjykohet si i aplikuar në këtë Konventë të ndryshuar në datën që amendamenti hyn në fuqi.

Neni 18
Denoncim

1. Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë këtë Konventë, duke i dërguar njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të ketë efekt 6 muaj nga data e marrjes së këtij materiali denoncimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 19
Mbarimi

1. Në qoftë se pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, numri i shteteve të cilat janë palë, është reduktuar në më pak se 5 shtete, për një periudhë 12 mujore, Konventa do të pushojë së pasuri efekt pas përfundimit të periudhës 12 mujore.

Neni 20
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese, që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, do të zgjidhet, me sa është e mundur, nëpërmjet negociimit ndërmjet tyre ose me anë të mjeteve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, që ka të bëjë me interepretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, e cila nuk mund të zgjidhet me mjetet që tregohen në paragrafin e parë të këtij neni, me kërkesën e njërit prej tyre, do t'i parashtrohet një gjykate arbitrazhi, e përbërë si më poshtë: secila palë në mosmarrëveshje do të emërojë një arbitër dhe të dy arbitrat e caktuar nga palët, caktojnë një arbitër tjetër i cili do të jetë kryetari i arbitrazhit. Në qoftë se tre muaj pas marrjes së kërkesës, njëra nga palët ka dështuar në emërimin e arbitrit të saj, ose në qoftë se arbitrat kanë dështuar në zgjedhjen e kryetarit, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të emërojë një arbitër ose kryetar të gjykatës së arbitrazhit.

3. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit, i marrë sipas paragrafit 2, do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për secilën palë në mosmarrëveshje.

4. Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë rregullat e saj të procedimit.

5. Gjykata e arbitrazhit do të marë vendimet e saj me anë të votimit të shumicës, në bazë të marrëveshjeve që ekzitojnë ndërmjet palëve në mosmarrëveshje dhe sipas ligjeve të përgjithshme ndërkombëtare.

6. Çdo kundërshtim, i cili mund të ngrihet ndërmjet palëve për mosmarrëveshjen në lidhje me interpretimin dhe ekzekutimin e vendimit të gjyqit, mund të dërgohet, nga secila palë, për gjykim në gjykatën e arbitrazhit e cila ka marrë vendimin e gjykimit.

7. Secila palë në mosmarëveshje do të marë përsipër shpenzimet lidhur me arbitrin e emëruar dhe të përfaqësuesve të tij në një proces arbitrazhi, shpenzimet e Kryetarit dhe shpenzimet e tjera të cilat do të ndahen në pjesë të barabarta ndërmjet palëve në mosmarrëveshje.

Neni 21

Rezervimet

1. Çdo palë kontraktuese mundet, në kohën e nënshkrimit, të ratifikimit, pranimit ose aprovimit të kësaj Konvente ose të aderimit në të, të deklarojë se nuk e konsideron veten të lidhur me nenin 20/2 deri në paragrafin 7 të kësaj Konvente. Palët e tjera kontraktuese, nuk do të jenë të lidhur me këtë paragraf, në marrëdhënie me çdo shtet, palë të kësaj Konvente, e cila e ka bërë një rezervim të tillë.

2. Çdo palë kontraktuese,që ka bërë një rezervim sipas paragrafit të mësipërm, mund në çdo kohë të tërheqë këtë rezervim, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së.

3. Përveç rezervimit, që është parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk do të lejohet asnjë lloj rezervimi tjetër që mund të bëhet nga çdo palë e kësaj Konvente.

Neni 22

Procedura për ndryshime në këtë Konventë

1. Kjo Konventë, duke përfshirë dhe anekset e saj, mund të ndryshojë me propozimin e palëve kontraktuese, sipas procedurave të veçanta të këtij neni.

2. Çdo ndryshim, i propozuar në këtë Konventë, do të merret në shqyrtim nga një Komitet Administrativ i përbërë nga të gjithë palët kontraktuese, duke respektuar rregullat e procedurës të përfshira në aneksin 7. Çdo ndryshim që është shqyrtuar ose miratuar gjatë takimit të Komitetit Administrativ dhe është adaptuar nga ai, duhet të komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së palëve kontraktuese për aderim.

3. Çdo ndryshim, i propozuar dhe i komunikuar në pajtim me paragrafin e mësipërm, do të hyjë në fuqi për të gjitha shtetet palë të kësaj Konvente, 3 muaj pas përfundimit të periudhës 12 mujore, duke filluar afati që nga data e komunikimit të ndryshimit të propozuar, periudhë gjatë së cilës, asnjë kundërshtim për ndryshimin e bërë nuk është paraqitur tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së nga shteti i cili është palë e kësaj Konvente, ose nga një organizatë rajonale e integrimit ekonomik, e cila është palë e kësaj Konvente dhe vepron në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 16 të paragrafit 2 të kësaj Konvente.

4. Në qoftë se një kundërshtim për ndryshimin e propozuar është komunikuar lidhur me paragrafin 3 të këtij neni, ndryshimi do të merret si i papranuar dhe nuk do të ketë asnjë lloj efekti.

Neni 23
Kërkesat, komunikimet dhe kundërshtimet

1. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të njoftojë të gjitha palët kontraktuese dhe të gjitha shtetet për çdo kërkesë, komunikim ose kundërshtim sipas nenit 22, si dhe për datën në të cilën çdo amendament hyn në fuqi.

Neni 24
Konferenca Rishikuese

Pas një kohe 5-vjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo palë e kësaj Konvente, nëpërmjet njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, të kërkojë të mbledhë konferencën me qëllimin e rishikimit të Konventës, duke treguar edhe propozimet të cilat do të jenë objekt diskutimi nga Konferenca. Në këto raste:

1. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të njoftojë të gjitha palët nënshkruese për kërkesën e bërë nga një shtet dhe t'i ftojë ato të parashtrojnë, brenda një kohe prej 3 muajsh, komentet e tyre, lidhur me propozimet ose me propozimet e tjera të cilat konferenca mund t'i marrë në konsideratë për t'i diskutuar.

2. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do t'i japë të gjitha palëve tekstin e propozimeve dhe do të mbledhë konferencën nëse, 6 muaj pas komunikimit në fjalë, jo më pak se 1/3 e palëve të kenë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së për miratimin e tyre për mbledhjen e kësaj Konference.

3. Megjithatë, në qoftë se Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e konsideron se një propozim për rishikimin e Konventës ka të bëjë më tepër me amendimin e tij, siç parashikohet edhe në nenin 22/1, ai mund, duke marë edhe pëlqimin e palës që ka bërë propozimin, të zbatojë procedurat e ndryshimit të parashikuar në nenin 22, në vend të përdorimit të procedurës së rishikimit.

Neni 25
Njoftimet

Përveç rasteve të lajmërimeve dhe komunikimeve të parashikuara në nenet 23 dhe 24, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të njoftojë të gjitha shtetet përsa vijon:

(a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe aderimet në bazë të nenit 16;

(b) datat e hyrjen në fuqi të Konventës, në zbatim të nenit 17 të kësaj Konvente;

(c) denoncimet, në bazë të nenit 18;

(d) mbarimin e kësaj Konvente, në bazë të nenit 19.

Neni 26
Kopjet origjinale

Pas 31 Marsit 1984, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të komunikojë dy kopje të vërtetuara të kësaj Konvente secilës palë të kësaj Konvente, si dhe të gjitha shteteve të tjera që nuk janë palë të kësaj Konvente.

Bërë në Gjenevë në datën 21 Tetor 1982, në një kopje origjinale. Kopjet në anglisht, frengjisht, rusisht dhe spanjisht janë njëlloj autentike.

Sa më sipër, palët e autorizuara e kanë nënshkruar këtë Konventë.

ANEKSI 1
HARMONIZIMI I KONTROLLIT DOGANOR DHE KONTROLLEVE TË TJERA

Neni 1
Parimet

1. Duke patur parasysh që shërbimi doganor ekziston në çdo vend, si dhe nisur nga natyra e tij

e përgjithshme, të tjera kontrolle përveç atij doganor, për sa është e mundur, do të organizohen në një mënyrë të koordinuar me kontrollet doganore.

2. Në zbatim të këtij parimi, është e mundur që të sigurohet përdorimi i procedurave të cilat do të mund të lehtësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, në qoftë se këto kontrolle ose pjesët e tyre do të ushtrohen jo në pikat e kalimit të kufirit.

Neni 2

1. Shërbimet doganore do të mbahen vazhdimisht të informuara për kërkesat ligjore ose rregulloret të cilat zbatohen në rastet e kontrolleve të tjera përveç kontrolleve doganore.

2. Kur gjykohet se të tjera kontrolle janë të nevojshme, doganat do të marrin masa që shërbimet e kryera për kontrollet e tjera, ndryshe nga kontrolli doganor, të bashkëpunojnë me këtë të fundit.

Neni 3
Organizimi i Kontrolleve

1. Kur kontrolle të ndryshme duhet të organizohen në të njëjtin vend, organet kompetente të shërbimit do të marrin masat e duhura për të kryer këto kontrolle në të njëjtën kohë, në qoftë se është e mundur dhe me sa më pak vonesë.

2. Në veçanti, organet kompetente do të marrin të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e personelit dhe të lehtësive të tjera në vendin ku do të kryhen kontrollet.

3. Doganat mund, nëpërmjet delegimit të shprehur të pushtetit nga organet kompetente të shërbimit, të kryejë në emër të tyre të gjitha ose pjesë të kontrolleve për të cilat organet kompetente janë përgjegjëse. Në këtë rast, këto shërbime, do të marrin masa për ofrimin e mjeteve të duhura doganave për të kryer kontrollin e deleguar.

Neni 4
Rezultatet e Kontrollit

1. Të gjitha çështjet për të cilat bën fjalë kjo Konventë, shërbimet e kontrollit dhe shërbimet doganore do të shkëmbejnë të gjitha informacionet lidhur me këto kontrolle sa më shpejt që të jetë e mundur, për të siguruar efikasitetin e kontrollit.

2. Në bazë të rezultateve të kontrolleve të kryera, autoritetet kompetente do të vendosin se çfarë trajtimi do t'i nënshtrohen mallrat e kontrolluara, dhe, në qoftë se është e nevojshme, do të informojnë shërbimet përgjegjëse për kryerjen e këtyre kontrolleve. Në bazë të këtij vendimi, shërbimi doganor do të zbatojë procedurat e veçanta doganore.

ANEKSI 2
KONTROLLI MJEKO-VETERINAR

Neni 1
Parimet

Kurdo që të kryhet ky kontroll, ai do të respektojë parimet e parashtruara në këtë Konventë dhe sidomos ato të përfshira në Aneksin e parë.

Neni 2
Informacioni

Çdo palë kontraktuese do të sigurojë që informacioni, lidhur me mallrat e mëposhtme, të jetë në dispozicion të çdo subjekti të interesuar duke përfshirë:

mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit mjeko-sanitar;

vendet në të cilat mallrat do të mund të paraqiten për ushtrimin e kontrollit;

kërkesat e përcaktuara nga ligje dhe rregullore për kontrollet mjeko-sanitare, si dhe procedurat

për aplikimin e tyre.

Neni 3
Organizimi i Kontrolleve

1. Shërbimet e kontrollit do të marrin masa për sigurimin e lehtësive, në pikat ku do të kryhet kontrolli mjeko-sanitar.

2. Kontrolli mjeko-ligjor mund të kryhet edhe në brendësi të territorit të një vendi, në qoftë se, nga certifikata e mallrave të transportuara dhe mjetet e transportit të cilat janë përdorur për transportimin e tyre, vërtetohet se mallrat nuk do të pësojnë ndonjë dëm ose do të shkaktojnë infektim gjatë transportimit të tyre.

3. Brenda kuadrit të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen sa është e mundur, të ulin numrin e kontrolleve të mallrave të cilat janë në tranzitim.

4. Kur mallrat duhet të ruhen derisa të përfundojnë procedurat e kontrollit mjeko-sanitar, shërbimet e organeve kompetente të çdo vendi, do të marrin masa për depozitimin e mallrave. Ky depozitim do të duhet të sigurojë kushtet e nevojshme për ruajtjen e mallrave, duke respektuar një minimum të kushteve të depozitimit të tyre.

Neni 4
Mallrat në Tranzit

Brenda kuadrit të kësaj Konvente, për sa është e mundur, palët kontraktuese do të merren me kontrollin mjeko-sanitar të mallrave në tranzit, duke respektuar kushtet që tranzitimi i tyre të mos sjellë rrezik për sëmundje infektive.

Neni 5
Bashkëpunimi

1. Shërbimet e inspektimit mjeko-sanitar do të bashkëpunojnë me shërbimet e njëjta të palëve kontraktuese, duke patur si qëllim lejimin e kalimit të mallrave të prishura, të cilat do t'i nënshtrohen kontrollit mjeko-sanitar, duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm.

2. Kur ngarkesa e mallrave të prishura është zbuluar gjatë kontrollit mjeko-sanitar, shërbimet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet e njëjta të vendeve të tjera, për destinacionin e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër që të jetë e mundur, duke përcaktuar arsyet të cilat çuan në kryerjen e kontrollit dhe masat pasuese të marra lidhur me mallrat e kontrolluara.

ANEKSI 3
KONTROLLI VETERINAR

Neni 1
Parimet

Kurdo që të kryhet kontrolli veterinar, do të respektojë parimet e parashtruara në këtë Konventë dhe, sidomos, ato të përfshira në Aneksin e parë.

Neni 2
Përkufizimet

Kontrolli veterinar, i përcaktuar në nenin 1 (d) të kësaj Konvente, mbulon gjithashtu edhe kontrollin mbi mjetet dhe kushtet e transportit të kafshëve dhe të prodhimeve të kafshëve. Ky kontroll mund të përfshijë edhe kontrollet lidhur me cilësinë, standardet dhe rregullat e ndryshme, si p.sh. kontrolli që synon ruajtjen e llojeve të rrezikuara, të cilat, për arsye të rritjes së efektivitetit, shoqërohen me kontrolle veteriniare.

Neni 3
Informacioni

Çdo palë kontraktuese do të marrë masa që informacioni t'i sigurohet çdo personi të interesuar lidhur me çështjet e mëposhtme:

Mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit veteriniar;

Vendet ku këto mallra i nënshtrohen kontrollit;

Njoftimet e detyrueshme lidhur me sëmundjet e mundshme;

Kërkesat ligjore lidhur me kontrollin veterinar, si dhe procedurat respektive lidhur me zbatimin e tij.

Neni 4
Organizimi i Kontrolleve

1. Palët kontraktuese do të përpiqen:

të ngrejnë, kur është e nevojshme dhe e mundshme, strukturat ndihmëse për kontrollin veterinar, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e qarkullimit të këtyre mallrave;

të krijojë lehtësi për lëvizjen e mallrave, sidomos duke koordinuar orët e punës së shërbimit të kontrollit veterinar me shërbimin e kontrollit doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës, kur ardhja e mallrave është lajmëruar më parë.

2. Kontrolli veterinar i prodhimeve të kafshëve duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që një vend i tillë të tregohet; si dhe mjetet e përdorura për transportimin e tyre të mos sjellin keqësim ose përhapjen e sëmundjeve ngjitëse gjatë transportimit të tyre.

3. Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të mallrave të prishura në tranzitim.

4. Kur mallrat do të duhet të mbahen derisa të përfundojë kontrolli veterinar, shërbimet e organeve kompetente të çdo pale duhet të marrin masa për depozitimin e tyre në vende të caktuara duke pasur parasysh që një depozitim i tillë të bëhet me sa më pak shpenzime dhe depozitimi në fjalë të sigurojë ruajtjen dhe mosdëmtimin e mallrave të depozituara.

Neni 5
Mallrat në Tranzit

Në kuadër të kësaj Konvente, çdo palë kontraktuese, sa të jetë e mundur, të reduktojë kontrollin veterinar të prodhimeve të kafshëve në tranzitim, kur, nisur nga rrethanat, nuk ka ndonjë rrezik për infektim me sëmundje ngjitëse.

Neni 6
Bashkëpunimi

1. Shërbimet e kontrollit veterinar do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i mallrave të cilat i nënshtrohen një kontrolli të tillë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur një ngarkesë e mallrave të prishura ose ngarkesë në kafshë të gjalla është zbuluar gjatë kontrollit veterinar e tyre, atëherë autoritetet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar malli, brenda një kohe sa më të shkurtër, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këtë rast.

ANEKSI 4
KONTROLLI FITOSANITAR

Neni 1
Parimet

Kurdo që të kryhet kontrolli veterinar, do të respektojë parimet e parashtruara në këtë Konventë dhe sidomos ato të përfshira në Aneksin e parë.

Neni 2
Përkufizimet

Kontrolli fitosanitar i përcaktuar në nenin 1 (e) të kësaj Konvente mbulon edhe kontrollin e mjeteve dhe të kushteve të transportimit të bimëve dhe të prodhimeve të tyre. Ky kontroll mund të përfshijë edhe masat të cilat synojnë në ruajtjen e llojeve të bimëve të cilat janë të rrezikuara.

Neni 3
Informacioni

Çdo palë kontraktuese do të marrë masa që informacioni t'i sigurohet çdo personi të interesuar, lidhur me çështjet e mëposhtme:

Mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit fitosanitar;

Vendet ku bimët ose prodhimet e tyre do t'i nënshtrohen kontrollit;

Listën e sëmundjeve të bimëve ose prodhimeve të tyre, për të cilat ka një sërë ndalimesh ose kufizimesh;

Listën e kërkesave ligjore, lidhur me kontrollin fitosanitar, si dhe procedurat respektive lidhur me zbatimin e tij;

Neni 4
Organizimi i Kontrolleve

1. Palët kontraktuese do të përpiqen:

të ngrejnë, kur shihet e nevojshme dhe e mundshme, mjetet e nevojshme, si kontrollin e duhur fitosanitar, depozitimin dhe dizinfektimin e bimëve dhe prodhimeve të tyre, duke respektuar edhe kërkesat e qarkullimit të tyre;

të lehtësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, sidomos koordinimin e orëve të punës së shërbimeve të kontrollit fitosanitar në atë të kontrollit doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës kur ardhja e mallrave është lajmëruar më parë.

2. Kontrolli fitosanitar i bimëve dhe prodhimeve të tyre duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që një vend i tillë të tregohet, si dhe mjetet e transportit të përdorura për transportimin e tyre të mos sjellin keqësim ose përhapjen e sëmundjeve ngjitëse gjatë transportimit të tyre.

3. Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të bimëve ose prodhimeve të tyre të prishura të cilat janë në tranzitim.

4. Kur mallrat do të duhet të mbahen derisa të përfundojë kontrolli fitosanitar, shërbimet e organeve kompetente të çdo pale duhet të marrin masa për depozitimin e tyre në vende të caktuara, duke patur parasysh që një depozitim i tillë të bëhet sa me më pak shpenzime dhe depozitimi në fjalë të sigurojë ruajtjen dhe mosdëmtimin e mallrave të depozituara.

Neni 5
Mallrat në Tranzit

Në kuadër të kësaj Konvente, çdo palë kontraktuese, sa të jetë e mundur, do të reduktojë kontrollin fitosanitar të bimëve dhe të prodhimeve të tyre, kur, nisur nga rrethanat, këto mos shihen të rëndësishëm për mbrojtjen e bimëve.

Neni 6
Bashkëpunimi

1. Shërbimet e kontrollit fitosanitar do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i bimëve ose prodhimeve të tyre, të cilat i nënshtrohen një kontrolli të tillë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur një ngarkesë e bimëve ose prodhimeve të tyre të prishura, është zbuluar gjatë kontrollit fitosanitar të tyre, atëherë autoritetet komptente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar bima brenda një kohe sa më të shkurtër, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këtë rast.

ANEKSI 5
KONTROLLI I PËRPUTHSHMËRISË ME STANDARDET TEKNIKE

Neni 1
Parimet

Kurdo që zbatohet ky lloj kontrolli, ai duhet të jetë në përputhje me standardet teknike, lidhur me mallrat e përfshira në këtë Konventë, do të duhet të përputhet me parimet e parashtruara në Konventë dhe sidomos në Aneksin 1.

Neni 2
Informacioni

Secila palë do të sigurojë që informacioni të jetë në dispozicion të çdo personi të interesuar lidhur me:

Standardet e aplikuara në të;

Vendin në të cilin do të bëhet kontrolli i mallrave;

Kërkesat ligjore, lidhur me përputhshmërinë e kontrolleve me standardet teknike, si dhe procedurat e zbatuara për kryerjen e këtyre kontrolleve.

Neni 3
Harmonizimi i Standardeve

Në mungesë të standardeve ndëkombëtare, palët kontraktuese të cilat gjatë këtyre kontrolleve zbatojnë standarde kombëtare, do të marrin masat që këto standarde kombëtare të jenë në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 4
Organizimi i Kontrolleve

1. Palët kontraktuese do të përpiqen:

të ngrejnë, kur shihet e nevojshme dhe e mundshme, qendrat për përputhjen e kontrollit të kryer me standardet teknike, duke respektuar edhe kërkesat e qarkullimit të tyre;

të lehtësojë lëvizjen e lirë të mallrave, sidomos koordinimin e orëve të punës së shërbimeve të kontrollit për përputhshmërinë e kontrolleve, me standardet teknike me atë doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës, kur ardhja e mallrave është lajmëruar më parë.

2. Kontrolli i përputhshmërisë me standardet teknike duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që një vend i tillë të tregohet, si dhe mjetet e transportit të përdorura për transportimin e tyre të mos sjellin keqësim gjatë transportimit të tyre.

3. Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të mallrave të prishura që janë në tranzitim, të cilat i nënshtrohen kontrollit për përputhshmërinë me standardet teknike.

4. Palët kontraktuese do të organizojnë kontrolle të përputhshmërisë me standardet teknike,

duke harmonizuar, kur është e mundur, procedurat e zbatuara për kontrollin e mallrave, të kryer nga shërbimet përgjegjëse, duke harmonizuar procedurat edhe me shërbimet e tjera përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve të tjera.

5. Në rastet e mallrave të prishura të cilat do të duhet të mbahen derisa të përfundojë kontrolli i përputhshmërisë me standardet teknike, shërbimet e organeve kompetente të çdo pale duhet të marrin masa për depozitimin e tyre në vende të caktuara, duke patur parasysh që një depozitim i tillë të bëhet me sa më pak shpenzime dhe depozitimi në fjalë të sigurojë ruajtjen dhe mosdëmtimin e mallrave të depozituara.

Neni 5
Mallrat në Tranzit

Kontrollet për përputhshmërinë e mallrave me standardet teknike nuk do të zbatohen mbi mallrat të cilat do të kalojnë tranzit.

Neni 6
Bashkëpunimi

1. Shërbimet përgjegjëse për kontrollin e përputhshmërisë së mallrave me standardet teknike do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i mallrave të prishura, të cilat i nënshtrohen një kontrolli të tillë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur një ngarkesë e mallrave të prishura, është zbuluar gjatë kontrollit të ushtruar për përputhshmërinë e tyre me standardet teknike, atëhere autoritetet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar malli brenda një kohe sa më të shkurtër, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këtë rast.

ANEKSI 6
KONTROLLI I CILËSISË

Neni 1
Parimet

Kurdo që zbatohet kontrolli i cilësisë së mallrave që përfshihen në këtë Konventë, do të duhet të përputhet me parimet e parashtruara në Konventë dhe sidomos në Aneksin 1.

Neni 2
Informacioni

Secila palë do të sigurojë që informacioni të jetë në dispozicion të çdo personi të interesuar lidhur me:

Vendin në të cilin do të bëhet kontrolli i mallrave;

Kërkesat ligjore lidhur me përputhshmërinë e kontrolleve të cilësisë, si dhe procedurat e zbatuara për kryerjen e këtyre kontrolleve.

Neni 3
Organizimi i Kontrolleve

1. Palët kontraktuese do të përpiqen:

të ngrejnë, kur shihet e nevojshme dhe mundshme, qendrat e kontrollit të cilësisë, në përputhje me kërkesat e qarkullimit të mallrave;

të lehtësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, sidomos koordinimin e orëve të punës së shërbimeve të kontrollit të cilësisë me atë doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës për mallrat e prishura, kur ardhja e tyre është lajmëruar më parë.

2. Kontrolli i cilësisë duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që

procedurat e përdorura gjatë kontrollit të lehtësojnë lëvizjen ndërkombëtare të mallrave.

3. Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të mallrave të prishura që janë në tranzitim, të cilat i nënshtrohen kontrollit cilësor.

4. Palët kontraktuese do të organizojnë kontrolle cilësore, duke harmonizuar, kur është e mundur, procedurat e zbatuara për kontrollin e mallrave të kryer nga shërbimet përgjegjëse, duke harmonizuar procedurat edhe me shërbimet e tjera përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve të tjera.

Neni 4
Mallrat në Tranzit

Kontrollet për cilësinë nuk do të zbatohen mbi mallrat të cilat do të kalojnë tranzit.

Neni 5
Bashkëpunimi

1. Shërbimet përgjegjëse për kontrollin e cilësisë do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i mallrave të prishura, të cilat i nënshtrohen kontrollit të cilësisë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur një ngarkesë e mallrave të prishura, është zbuluar gjatë kontrollit cilësor të ushtruar, atëhere autoritetet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar malli brenda një kohe sa më të shkurtër, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këtë rast.

ANEKSI 7
RREGULLAT E PROCEDURËS PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT ADMINISTRATIV I CILI ËSHTË PËRMENDUR NË NENIN 22 TË KËSAJ KONVENTE

Neni 1
Anëtarët

Anëtarë të Komitetit Administrativ do të jenë palët kontraktuese në këtë Konventë.

Neni 2
Vëzhguesit

1. Komiteti administrativ mund të vendosë të ftojë administratorët kompetentë nga të gjithë shtetet të cilat nuk janë palë të kësaj Konvente, ose përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilat nuk janë palë kontraktuese për të ndjekur, pyetur për çështje që interesojnë atyre në sesionet e Komitetit me statusin e vëzhguesit.

2. Pa paragjykuar nenin 1 të kësaj Konvente, organizatat ndërkombëtare të cilave u referohemi në paragrafin 1, të cilat janë kompetente për çështjet e adresuara atyre në kuadër të anekseve të kësaj Konvente, kanë të drejtën të marrin pjesë si vëzhgues në punën e Komitetit adminsitrativ.

Neni 3
Sekretariati

Sekretari i Komitetit do të caktohet nga Sekretari ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën.

Neni 4
Mbledhjet e Komitetit

Sekretari ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën do të mbledhë Komitetin:

(i) Dy vjet pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi;

(ii) Pastaj në datën e caktuar nga Komiteti por jo më vonë se në periudhë 5-vjeçare;

(iii) Me kërkesën e administratorëve kompetente së paku 5 shteteve të cilat janë palë të kësaj Konvente.

Neni 5
Zyrtarët

Komiteti do të zgjedhë një Kryetar dhe një nën-Kryetar me rastin e mbledhjes së çdo sezoni të tij.

Neni 6
Kuorumi

Një kuorum i përbërë nga jo më pak se 1/3 e shteteve të cilat janë palë të kësaj Konvente, kërkohet për efektin e marrjes së vendimit.

Neni 7
Vendimet

(i) Propozimet do të hidhen në votë;

(ii) Çdo shtet palë e kësaj Konvente, do të ketë të drejtën e një vote;

(iii) Në rastin e zbatimit të nenit 16/2 të Konventës, palët e organizatave të integrimit ekonomik rajonal do të kenë vetëm një të drejtë vote e cila do të jetë shuma e votave të shteteve të cilat janë palë të kësaj organizate. Në këto raste shtetet palë të kësaj Konvente nuk kanë të drejtën e votës.

(iv) Në rastet e parashikuara në nënparagrafin e mëposhtëm, çdo propozim do të miratohet nga një magjiorancë e thjeshtë që përfshin anëtarët e pranishëm të cilët do të votojnë në pajtim me kushtet e përcaktuara në paragrafin (ii) dhe (iii).

(v) Ndryshimet e kësaj Konvente do të miratohen nga 2/3 e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nënparagrafin (ii) dhe (iii).

Neni 8
Raporti

Para mbylljes së çdo sezoni, Komiteti do të miratojë raportin e tij.

Neni 9
Nene Shtese

Në mungesë të neneve të cilat nuk janë përfshirë në këtë Aneks, Rregullat e Procedurës të Komisionit Ekonomik për Europën do të jenë drejtpërdrejt të zbatueshme, përveç rasteve kur Komiteti vendos të veprojë ndryshe.